



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 313/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetvendosje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të heqjes dhe dëmtimit të posterave , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar

ARSYETIM

Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka bërë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës neni 33 pika (a) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë veprime të ndaluara ku më datë 02.12.2010 ora 15:24 në fshatin Drejkovc komuna e Shtërpcës anëtarët e shtabit zgjedhor të PDK-së kanë hequr dhe dëmtuar posterin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Më 03 Dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Lëvizja Vetëvendosje, duke pretenduar se subjekti politik PDK, ka bërë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës neni 33 pika (a) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a).

Më datën 12.02.2010 ora 15:24 në fshatin Drejkovc komuna e Shtërpcës anëtarët e shtabit zgjedhor të PDK-së kanë bërë heqjen dhe dëmtimin e posterit të Lëvizjes Vetëvendosje Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se anëtarë e PDK-së kanë dëmtuar posterin e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe se fotot e ofruara si prova nuk japin ndonjë dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar, pasi që heqja dhe dëmtimi i posterit ka mundur të bëhet nga çdokush.

Lëvizja Vetëvendosje nuk ka dorëzuar fakte të qarta dhe të argumentuara të cilat argumentojnë ankesën.

PZAP-i konsideron që Lëvizja Vetëvendosje nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

A nr. 313/2010 më datën 06.12.2010.

